



Nr. 40 prot
Dt. 15/10/2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr.28, datë 12/10/2021

**“MBI KORIGJIMIN GABIMIT NË VENDIMIT NR. 18, DATË
23.04.2021 PËR MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË
BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM
HIDROENERGJIE SHOQËRISË SIMA-COM SH.P.K" ME NR. 243
PROI, DATË 29.04.2021 DHE NR. SERIAL 000146”**

Bazuar në pikën 2, neni 50, të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr. 550, datë 15.07.2020 të Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimeve ujore, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", si dhe në pikën 1 e 2, nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative: "Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ, me kërkesë të Subjektit dhe me aprovim të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore pasi konstatoi se kërkesa e subjektit qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujqor Drin Bunë.

VENDOSI:

1. Korigjimin e gabimit material në "Leje për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor" me nr. 243 prot., datë 29.04.2021 dhe nr. Serial 000146, Vendimin nr. 18, datë 23.04.2021, në rubrikën Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për Prodhim Hidroenergjiqe (H/C Rukaj) është bërë gabim material në emrin e H/C është shkruar (H/C

Rukaj) ndërkohë duhet të jetë: në rubrikën Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për Prodhim Hidroenergjie (H/C Rrukaj).

2. Në vendimin nr. 18, datë 23.04.2021, të Këshillit të Basenit Ujor Drin Bunë në emërtimin e vendimit është bërë gabim material, është shkruar "Vendim për miratimin e lejes për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie shoqërisë "SIMA-COM" SH.P.K ndërkohë që duhet të jetë: "Vendim për miratimin e lejes për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik shoqërisë "SIMA-COM" SH.P.K & "ROLAND" SH.P.K"
3. Në dispozitivin e vendimit nr.18, datë 23.04.2021 në pikën 1, është shkruar: "miratimin e lejes "Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik", shoqërisë " SIMA-COM " sh.p.k ndërkohë që duhet të jetë: "miratimin e lejes "Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie", shoqërisë "SIMA-COM" sh.p.k & "ROLAND" sh.p.k.
4. Në dispozitivin e vendimit nr. 18, datë 23.04.2021 në pikën 2, është shkruar: HEC RUKAJ e ndërkohë që duhet të jetë: " HEC RRUKAJ".
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

